



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	26.10.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinstva Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPSHICK	6705/2023		1/6



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.1123/2023**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-** Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbaitësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1123/2023, të datës 29.08.2023 të ankuesit [redacted] me adresë banimi: Kompleksi Banesor "L... ..", Veternik, Komuna e Prishtinës, kundër Vendimit me numër:4892/02 i datës 18.08.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike "*masë disiplinore*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 26.10.2023, mori:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.1123/2023 e datës 29.08.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted] për shkak të shkeljeve procedurale.**
- II. Anullohet Vendimi me numër:4892/02 i datës 18.08.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.**
- III. Detyrohet Komisioni Disiplinor që të nxjerrë akt administrativ për pezullimin e procedurës disiplinore të iniciuar ndaj ankuesit sipas kërkesës së datës 21.07.2023 të Zëvendësueses së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës-ARBK.**
- IV. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën III të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të tij.**
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**

## A r s y e t i m

Ankuesi sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (*tani e tuje referuar si MINT*), me datë 29.08.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyresh për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është protokolluar me numër:5843/2023 e plotësuar përmes shkresë së datës 12.09.2023, kundër Vendimit me numër:4892/02 i datës 18.08.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Komisionin Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 18.08.2023 nuk ka konstatuar saktë gjendjen faktike, ngase nuk ka bërë ndarjen se gjatë së cilës periudhë kohore ankuesi ka ushtruar detyrat dhe përgjegjësitë për pozitën e Drejtorit të Drejtoratit për Çështje Administrative për Regjistrimin e Bizneseve në ARBK dhe pozitën Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm i ARBK-së, Komisioni Disiplinor nuk ka përcaktuar se cilin përkrahim të detyrave të punës apo dispozitë të akt emërimit e ka shkelur, me theksin e veçantë se Komisioni Disiplinor ka zbatuar gabimisht dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik kur të njëjtat i ka përdorur në kuptim retroaktiv për periudhën kohore të vitit 2015, 2016 dhe 2017 kur i njëjti gjatë kësaj kohe s'ka qenë në fuqi dhe se nuk ka prodhuar efekte juridike, sikurse janë zbatuar gabimisht edhe dispozitat e nenit 7, nenit 9 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej KPMSHCK*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 31.08.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Ndërsa me datë 05.09.2023, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Sipas kërkesës së anëtarëve të Kolegjit, me datë 06.10.2023 Kryetari i Këshillit ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2023 dhe numër protokolli:6424/2023, përmes së cilit ankesës së ankuesit A.nr.1123/2023 të datës 29.08.2023 ia ka vazhduar afatin vendimmarrës edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën e datës 29.08.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Plotësim ankesë e datës 12.09.2023; Vendimi me numër:4892/02 i datës 18.08.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; E-mailin e datës 11.09.2023 dërguar nga L.H për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej katër e-maileve; Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 17.08.2023 me shifër :4883/02; Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 17.08.2023 me shifër :4884/02; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 31.08.2023; Përgjigjen në kërkesë e datës 05.09.2023; Ndryshimi dhe Plotësimi i akt emërimit të ankuesit i datës 07.05.2015; Përkrahimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Departamentit për Çështje Administrative të Regjistrimit të Biznesit; Vendimin e datës 17.05.2021 të Ministres së MINT; Vendimin e datës 24.02.2023 të Ministres së MINT; Vendimin e datës 22.01.2008 të Ministrit të MTI-së; Vendimin e datës 07.04.2015 të Sekretarit të Përgjithshëm të MTI-së; Kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore e datës 21.07.2023; Procesverbalin e datës 01.08.2023 i orës 10:20; Procesverbalin e datës 02.08.2023; Procesverbalin e datës 01.08.2023 i orës 08:40; Procesverbalin e datës 31.07.2023 i orës 08:20; E-mailin e datës 25.05.2023 i orës 12:09 dërguar nga V.R-V për ZL.H; E-mailin e datës 25.05.2023 i orës 12:02 dërguar nga V.R-V për ankuesin; E-mailin e datës 31.07.2023 dërguar nga V.R-V për F.L me korrespondencën e bashkangjitur; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2016;

Formularin e vlerësimi të rezultateve në punë i datës 31.01.2021; E-mailin e datës 24.07.2023 dërguar nga L.H për Z.K; Raportin e datës 21.07.2023 për ri-verifikim të dosjeve në Asgjësinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës; E-mailin e datës 24.07.2023 dërguar nga Z.K për L.H me korrespondencën e bashkangjitura prej dy faqesh; Lista e bizneseve e të evidentuara; E-mailin e datës 25.07.2023 dërguar nga V.R-V për ankuesin; E-mailin e datës 31.07.2023 dërguar nga ankuesi për Z.K me korrespondencën e bashkangjitur; Shkresën e titulluar "historia e biznesit" Klan Kosova Sh.P.K me të dhënat e pronarëve në përbërje prej 3 faqesh; Fletëparaqitje për ndërrim të pronarëve-aksionarëve me numër:1950015302 me dosjen e bashkangjitur; Fletëparaqitje për ndërrim të pronarëve-aksionarëve me numër:1950011108 me dosjen e bashkangjitur; E-mailin e datës 11.07.2023 dërguar nga M.P për F.L; E-mailin e datës 17.07.2023 dërguar nga M.P për F.L; E-mailin e datës 24.07.2023 dërguar nga D.B për ankuesin; E-mailin e datës 25.07.2023 dërguar nga M.F për ankuesin; E-mailin e datës 26.07.2023 dërguar nga L.H për ankuesin me korrespondencën prej 3 faqesh; E-mailin e datës 31.07.2023 dërguar nga ankuesi për Z.K; E-mailin e datës 01.08.2023 dërguar F.L për Z.K; E-mailin e datës 01.08.2023 dërguar F.L për Z.K i orës 11:28; E-mailin e datës 01.08.2023 dërguar F.L për Z.K i orës 11:25 me korrespondencën e bashkangjitur; Vendimin për ndryshimin e statutit i datës 14.02.2023; Shkresën e ARBK-së për numrin e biznesit:70542943; Aktin noterial i datës 06.04.2018; Kopjen e letërnjoftimit të L.B; Kopjen e letërnjoftimit të B.H; Shkresë e transaksionit bankar NLB i datës 04.03.2019; Çertifikatën e regjistrimit 70542943 të datës 03.12.2008; E-mailin e datës 02.08.2023 dërguar nga M.P për Z.K; Raportin e Auditimit të Brendshëm i datës 10.09.2021; E-mailin e datës 03.08.2023 dërguar nga M.P për Z.K; Shkresat e titulluara "historiku i një numri të protokollit"; E-mailin e datës 04.08.2023 dërguar nga Mehdi Pllashniku; Aktvendimin KA.nr.315/23 të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative i datës 02.08.2023; vendimin për pushim i datës 20.06.2023; Vendimin e Zv. Drejtoreshës së Përgjithshme të ARBK-së i datës 14.06.2023; Vendimin për Korrigjim i datës 15.06.2023; Vendimin e Zv. Drejtoreshës së Përgjithshme të ARBK-së i datës 21.06.2023 më numër:333; Vendimin e Zv. Drejtoreshës së Përgjithshme të ARBK-së i datës 21.06.2023 më numër:333.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesi [REDAKTUAR], është pjesërisht e bazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se ankuesi sipas Ndryshimit dhe plotësimit të Aktit të emërimit të datës 07.05.2015 ka të themeluar marrëdhënien e punës në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në pozitën "Drejtor i Drejtoratit për Çështje Administrative të Regjistrimit të Biznesit në ARBK", kurse përmes Vendimit me numër prot:3745 të datës 19.05.2021 të nxjerrë nga Ministrija e MINT i njëjti është caktuar Zëvendësues i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës-ARBK, kurse përmes Vendimit me shifër: Ref.Nr.01/09 të datës 24.02.2023 të nxjerrë nga Ministrija e MINT është shfuqizuar Vendimi me numër prot:3745 i datës 19.05.2021 përmes të cilit ankuesi ishte caktuar Zëvendësues i Drejtorit të Përgjithshëm të ARBK-së, nga lë të kuptohet se ankuesi pas datës 24.02.2023 i ka ushtruar detyrat e punës në pozitën e emëruar sipas akt emërimit të datës 07.05.2015.

Po ashtu, nga shkresat e lëndës është gjetur se Zëvendësuesja e Drejtorit të Përgjithshëm të ARBK-së me datë 21.07.2023 përmes shkresës me numër prot:543/02 i është drejtuar Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit me arsyetimin se i njëjti ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës të përcaktuara me

nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.3 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik nën pretendimin se ankuesi në cilësinë e udhëheqësit/personit përgjegjës ka krijuar praktika të kundërligjshme e që për pasojë në dosjet e bizneseve të regjistruara në ARBK, respektivisht "Klan Kosova" sh.p.k dhe "Art Motion" sh.p.k me rastin e regjistrimi u janë pranuar dokumente të cilat kanë përmbajtje në kundërshtim me parimet e Kushtetutës së Kosovës dhe legjislacionit në fuqi, ashtu që në rubrikën qyteti/shteti i lindjes janë përdorur Pejë-Serbia, Gjakova-Serbia. Tutje në të njëjtën shkresë të inicimit të procedurës disiplinore specifikohet se sipas raportit të Komisionit të Brendshëm të MINT me numër protokoll:4427 të datës 21.07.2023 pas rivlerësimit të dosjeve në ARBK rezulton se edhe 48 biznese të tjera janë lejuar të regjistrohen apo të bëjnë ndryshim në ARBK me të njëjtat shkelje.

Komisioni Disiplinor duke vepruar sipas kërkesës së për inicim të procedurës disiplinore, pas mbajtjes së seancave disiplinore, me datë 18.08.2023 ka nxjerrë Vendimin me shifër:4892/02 përmes të cilit ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë në dy (2) vite" pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension, për shkak se të njëjtin e ka gjetur përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore të caktuara me nenin 46 paragrafi 3 në paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, me arsyetimin se ankuesi nuk ka përmbushur apo nuk ka zbatuar drejtë detyrat e punës, lidhur me rastet të cilat përcaktohen edhe në shkresën e inicimit të procedurës disiplinore të datës 21.07.2023 ku dosjet e bizneseve të regjistruara në ARBK, respektivisht "Klan Kosova" sh.p.k dhe "Art Motion" sh.p.k dhe njëzeteshtatë (27) bizneseve të tjera me rastin e regjistrimi u janë pranuar dokumente të cilat kanë përmbajtje në kundërshtim me parimet e Kushtetutës së Kosovës dhe legjislacionit në fuqi, ashtu që në rubrikën qyteti/shteti i lindjes janë përdorur Pejë-Serbia, Gjakova-Serbia, sipas dokumenteve të lëshuara nga Republika e Serbisë apo Republika e Malit të Zi.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë pas të gjeturave si më lart lidhur me shkeljet e pretenduara nga ankuesi që kanë të bëjnë me pranimin e dokumenteve në dosjet e bizneseve të regjistruara, me datë 14.06.2023 përmes Vendimit nr.309/11 të nxjerrë nga Zëvendës Drejtoresha e Përgjithshme e ARBK-së i është pezulluar Çertifikata e biznesit kompanisë "Klan Kosova Sh.P NUI810795297" të datës 29.05.2020, kundër të cilit vendim biznesi respektiv kishte parashtruar ankesë të brendshme, ndërsa Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve përmes Vendim të datës 28.07.2023 i ka refuzuar ankesën palës ankuese, e cila ndaj të njëjtës ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës. Tutje, Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative me datë 02.08.2023 ka nxjerrë Aktvendimin KA.nr.315 përmes të cilit ka aprovuar kërkesën e paditësit Klan Kosova për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të datës 28.07.2023 të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve dhe Vendimit nr.309/11 të nxjerrë nga Zëvendës Drejtoresha e Përgjithshme e ARBK-së derisa Gjykata të vendos meritorisht me vendim përfundimtar përkitazi me padinë e palës paditëse.

Pas konstatimit të gjendjes faktike si më lartë, Kolegji i Këshillit me qëllim të analizimit të ligjshmërisë së aktit administrativ të goditur përmes kësaj ankesë nëse me rastin e nxjerrjes së të njëjtit janë zbatuar dispozitat e LPPA-së, e në mbështetje të dispozitave të nenit 2 paragrafi 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se "Ky ligj zbatohet në çdo rast kur një organ publik në realizimin e autoritetit publik: 1.1. vendos për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave, si dhe çdo rast tjetër kur ligji parashikon shprehimisht nxjerrjen e një akti administrativ," ka analizuar dispozitat e nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: "Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së

*cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: "çështje paraprake"), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit", dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se në rrethanat e rastit konkret ka ekzistuar në mënyrë të pamohueshme rrethana juridike e njohur si "çështje paraprake", ngase përmes Aktvendimit KA.nr.315 të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 02.08.2023 është konfirmuar fakti se kjo gjykatë ka në shqyrtim meritore padinë e palës paditëse, kompanisë apo biznesit "Klan Kosova" e që objekt i së njëjtës është shqyrtimi i ligjshmërisë së anulimit të Çertifikatës së regjistrimit të biznesit nga ana e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë mbi bazën e të njëjtave arsye për të cilat edhe ankuesi ishte shpallur përgjegjës, respektivisht nëse biznesi në fjalë është regjistruar brenda kuadrit ligjor në fuqi.*

Prandaj, Kolegji i Këshillit konstaton se me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 18.08.2023 përmes të cilit ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore, Komisioni Disiplinor ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht është shkelur neni 85 paragrafi 1 i të njëjtit ligj, andaj duke u mbështetur në nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative" arrihet në përfundimin se Vendimi i datës 18.08.2023 i Komisionit Disiplinor është akt administrativ i paligjshëm, për shkak se Komisioni Disiplinor përderisa ka qenë në dijeni se ekziston dhe e ka administruar si provë Aktvendimin KA.nr.315 të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 02.08.2023, sipas të cilit konstatohet fakti se është plotësuar parakushti ligjorë gjegjësisht është konfirmuar fakti se ka ekzistuar çështja paraprake me ç'rast Gjykata Komerciale e Kosovës sipas kompetencës lëndore, ka pasur dhe e ka ende në shqyrtim ligjshmërinë ose jo të regjistrimit të biznesit në fjalë e ku për pasojë lënda nga Komisioni Disiplinor është dashur të pezullohet deri në zgjedhjen e çështjes paraprake ngase në rrethanat e rastit konkret faza e shqyrtimit pranë organit gjyqësor kompetent paraqet parakusht ligjor për zgjidhjen e çështjes kryesore, ngase verdikti final i gjykatës kompetente më pastaj do hapte rrugë për zgjedhjen e çështjes kryesore nga Komisioni Disiplinor, rrjedhimisht konstatimi nga ky i fundit nëse ankuesi ka kryer shkelje disiplinore, gjegjësisht nëse i njëjti nuk ka vepruar në pajtueshmëri me kuadrin ligjor në fuqi me rastin e regjistrimit të biznesit në fjalë.

Andaj nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit e ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankuesit vetëm për shkak të konstatimit të shkeljeve procedurale lidhur me dispozitat e lartcekura të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nga ana e Komisionit Disiplinor, dhe si i tillë Vendimi i datës 18.08.2023 i Komisionit Disiplinor është anuluar sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, ndërsa Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me qëllim të kthimit të ligjshmërisë duhet të nxjerrë akt administrativ përmes të cilit do të pezullojë procedurën e iniciuar disiplinore ndaj ankuesit sipas kërkesës së datës 21.07.2023 të Zëvendësueses së Drejtorit të Përgjithshëm të ARBK, në pajtim nenin 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nga rrjedh se Komisioni Disiplinor pas përfundimit në instanca gjyqësore respektivisht pas konstatimit se çështja paraprake e përcaktuar si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi është zgjedhur nga gjykata kompetente përmes aktit përfundimtar dhe i njëjti ta ketë marrë fuqinë e formës së prerë, atëherë Komisioni Disiplinor mund të vendos të aktivizojë lëndën për trajtim dhe vendosje lidhur me iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit.

Kolegji i Këshillit, thekson faktin se për shkak se ekziston rrethana e juridike e çështjes paraprake në kuptim të nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nuk ka mundur të shqyrtoj pretendimet e tjera ankimore të ankuesit lidhur me shkeljet materiale dhe zbatimin të gabuar të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, konstatimit të gjendjes faktike nga ana e Komisionit Disiplinor si dhe çështjen e kompetencës së këtij të fundit, ndërsa akti i administrativ i goditur përmes kësaj ankese ka pasur të meta ligjore për shkak të shkeljeve procedurale nga ana e Komisionit Disiplinor sikurse u theksua më latë në arsyetimin e këtij vendimi dhe i njëjti është anuluar ndërsa ankesa e ankuesit është aprovuar pjesërisht vetëm lidhur me shkeljet procedurale përderisa pretendimet e tjera ankimore nuk janë shqyrtuar për arsytet e dhëna si më lart, kurse pala kundërshtarë në këtë procedurë është udhëzuar dhe detyruar në marrjen e veprimeve sipas pikëpamjeve të dhëna ligjore të këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1123/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ndërmarrësisë, Industrisë dhe Tregtisë;
- Komisionit Disiplinor të të Ministrisë së Ndërmarrësisë, Industrisë dhe Tregtisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrisë së Ndërmarrësisë, Industrisë dhe Tregtisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së.